

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Gjeodezisë, kërkon të punësojë 3 (tre) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë asistent lektor për lëndët “Fotogrametri”, “Përpunim Imazhesh”, “Hartografi Dixhitale”, “Gjeodezi Inxhinierike”, “Nivelimi i saktësisë së lartë”, “Astronomi” dhe “Kadastër”.

A- Kriteria Kualifikuese:

1. Të jetë diplomuar në degën Gjeodezi, në ciklin Master Shkencor ose sistemi i integruar 5-vjeçar, në FIN të UPT ose univeristete analoge të huaja.
2. Nota mesatare e përgjithshme e ponderuar e studimeve të larta të të dy cikleve apo e ciklit të integruar të jetë së paku 80/100.
3. Të zotërojë një gjuhë të huaj (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht), me dëshmi apo çertifikatë.

B- Kriteria vlerësuese

1. Tituj shkencorë/akademikë;
2. Nota mesatare;
3. Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit;
4. Përvojë pune si personel akademik pranë një universiteti të njohur zyrtarisht nga MASR;
5. Të demostrojë me dokumenta eksperiencën në disiplinën për të cilën konkuron;
6. Publikime në formë artikujsh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit;
7. Prezantime/Referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
8. Intervista nga komisioni vlerësues.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **25.09.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose “DOKTOR” të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);

6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.